



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKË SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 02/12/2019

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “I.D.K-Konstruksion” shpk me NUIS K51408016J dhe me adresë: Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Berxulle, Vorë, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-39053-10-11-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit semaforik” afati: 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 42, Date 21.10.2019.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Shoqëria “Fred Electronic” shpk me NUIS K91803020F dhe me vlerë 7.726.400 (shtatë milion e shtatëqind e njëzetë e gjashtë mijë e katërqind) leke pa TVSH.
2. Shoqëria “I.D.K-Konstruksion” shpk me NUIS K51408016J dhe me vlerë 7.880.000 (shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) leke pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Fred Electronic” shpk me NUIS K91803020F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi *skeda teknike / katalogë*, ku të pasqyrohen karakteristikat teknike të këtyre mallrave, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.” pasi nuk

ka paraqitur skedë teknike /katalogë për të gjitha mallrat, objekt prokurimi të pasqyruara në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”. Konkretisht, nuk ka paraqitur skedë teknike / katalogë për zërat:

Ushqyesi i kamerës
Skedë detektor numërues
Skedë detektor klasifikues

b) Nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se “Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e mallrave të mëposhtëm, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit në datën dhe orën e hapjes së ofertave. **Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s’kualifikim.**

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Blloku i ushqimit	Copë	1
2	Skedë dalje	Copë	1
3	CPU 40	Copë	1
4	Skedë detektor numërues	Copë	1
5	Ekrani i centralit	Copë	1
6	Skedë detektor klasifikues	Copë	1

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostra për zërat:

- Skedë dalje
- CPU 40
- Skedë detektor numërues
- Skedë detektor klasifikues

Për zërin “Blok ushqimi” janë paraqitur 6 të tillë , nga 1 që është kërkuar, përkatësisht 1 copë me fuqi 5V, 2 copë me fuqi 12V dhe 2 copë me fuqi 24V. Asnjë nga mostrat e paraqitura nuk përputhet me skedën teknike të ngarkuar nga operatori ekonomik në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Për zërin “Ekрани i centralit” është paraqitur një mostër, e cila nuk përputhet me skedën teknike të ngarkuar nga operatori ekonomik në Sistemin e Prokurimit Elektronik

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**I.D.K-Konstruksion**” shpk me NUIS K51408016J dhe me adresë: Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Berxulle, Vorë, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **7.880.000** (shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 19.11.2019.

Ankesa: Nuk ka.